



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>2-D/DPK</u>	Br. Prot. <u>01-4092/15</u>
Dep.	Prot. No.
Nr. l faq.	Data
Broj stranica <u>02</u>	Datum <u>13.11.2015</u>
Nr. pages	Date
	<u>13.11.2015</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.11.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2782/15, për zyrtarin e lartë z. Lorenc Marleku, Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës së Klinës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur situatën e mundshme të Konfliktit të Interesit

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-2782/15, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Lorenc Marleku, Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës Klinës.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, z. Lorenc Marleku, Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës Klinës, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë është i identifikuar se ushtron veprimtari private si person i autorizuar ne biznes privat e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin te funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 21.09.2015 e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Lorenc Marleku, ka ardhur ne zyrat tona ku nga zyrtarët e AKK-së, është njoftuar për situatën ne të cilën gjendet.

z. Lorenc Marleku, është pajtuar me gjendjen, por është arsyetuar se nuk ka qen ne dijani se kjo situatë është ne kundërshtim me ligjin ne fuqi por është zotuar se brenda afatit ligjor do të bej ndryshimet dhe do te largohet nga pozita e personit te autorizuar ne ketë biznes .

Me datën 05.11.2015, kemi pranuar dokumentin zyrtar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se z. Lorenc Marleku, nuk figuron me si person i autorizuar ne bizneset “N.P.SH “NOLI” me nr .70054222.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga z. Lorenc Marleku, Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës se Klinës, duke bërë ndryshimet sipas kërkesës së AKK-së, ne biznesin ku ka vepruar si person i autorizuar, dhe pasi janë krijuar rrethana të reja konsiderojmë se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Lorenc Marleku, Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës së Klinës. Andaj u vendos si ne dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

